

VENDIM
Nr. 146, datë 8.7.2025

MBI MIRATIMIN E DOKUMENTIT PËR “UDHËZIMET PËR TESTIMIN E TREGUT TË GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK”, PROPOZUAR NGA TAP AG MË 16 QERSHOR 2025

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 13; 15, pika 1; dhe 108, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar; *Dispozitave të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë* (Opinionit Përfundimtar i Përbashkët), Korrik 2013; *Opinionit 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë*, datë 14 Maj 2013, “Mbi përjashtimin e gazsjellësit TAP AG, nga kërkesa të caktuara sipas Direktivës 2009/73/EC nga Autoriteti Rregullator i Energjisë i Shqipërisë”, Rregullorja e Komisionit (BE) 2017/459 e datës 16 mars 2017 “Për vendosjen e një kodi rrjeti për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit dhe shfuqizimin e Rregullores (BE) Nr. 984/2013” (Mekanizmi për Alokimin e Kapacitetit për Kodin e Rrjetit); vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 103, datë 26.06.2019, “Mbi miratimin e Transpozimit të Rregullores 2017/459 të miratuar me vendimin nr.2018/06/PHGL-ENC “Mbi themelimin e kodit të rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit”; si dhe neneve 15 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin të bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.07. 2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2011 prot., datë 03.07.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi miratimin e dokumentit për “Udhëzimet për testimin e tregut të gazsjellësit Trans Adriatik, “propozuar nga TAP AG më 16 qershor 2025”,

Duke patur parasysh:

- Direktivën 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009, “Për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror”;
- Direktivën (BE) 2019/692 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17 prill 2019, “Për ndryshimin e Direktivës 2009/73/EC për rregullat e tregut të brendshëm të gazit natyror”;
- Rregulloren (BE) 2017/459 të Komisionit, datë 16 mars 2017, “Për vendosjen e një kodi rrjeti për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit” (CAM NC);
- Rregulloren (BE) 2019/942 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 5 qershor 2019, “Për themelimin e Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë”;
- Vendimin e Komisionit Evropian, nr. C(2013)2949 final, datë 16 maj 2013, “Për përjashtimin e Gazsjellësit Trans Adriatik nga detyrimet për aksesin e palëve të treta, rregullimin e tarifave dhe ndarjen e pronësisë, sipas neneve 9, 32, 41(6), 41(8) dhe 41(10) të Direktivës 2009/73/EC”;
- Paragrafin 4.1.7 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të autoriteteve rregullatore të energjisë të Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, sipas të cilit TAP AG duhet të kryejë rregullisht (të paktën çdo dy vjet) një testim tregu, me qëllim ofrimin e kapaciteteve shtesë për palët e interesuara deri në arritjen e kapacitetit maksimal të zgjerimit të tubacionit.
- Testimi i Tregut, duhet të realizohet në përputhje me Udhëzimet e miratuara bashkarisht nga Autoritetet Rregullatore të energjisë të Shqipërisë (ERE), Greqisë (RAE) dhe Italisë (ARERA)
- Më datë 29 gusht 2011, shoqëria TAP AG paraqiti në Ministrinë Italiane të Zhvillimit Ekonomik kërkesën për përjashtimin e Gazsjellësit Trans Adriatik, dhe më datë 31 gusht 2011, e njëjta kërkesë u paraqit pranë Autoritetit Rregullator të Energjisë në Greqi (RAE), në përputhje me nenin 36 të Direktivës 2009/73/EC “Për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror”. Më datë 1 shtator 2011, TAP AG paraqiti pranë Entit Rregullator të Energjisë (ERE) kërkesën për përjashtimin e Gazsjellësit Trans Adriatik, në përputhje me nenin 22 të Direktivës 2003/55/EC.
- Në qershor 2013, Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Italisë, Autoriteti Rregullator i Energjisë i Greqisë (RAE) dhe Enti Rregullator i Energjisë (ERE) miratuan përjashtimin për Gazsjellësin Trans Adriatik, nëpërmjet Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, një dokument i përgatitur në mënyrë të koordinuar nga ARERA, ERE dhe RAE (këtu e në vijim: “Autoritetet”). Ky opinion u rishikua për t’u përputhur me vendimin e Komisionit Evropian nr. C(2013)2949 final, datë 16 maj 2013, dhe mori gjithashtu në konsideratë Opinionin nr. 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 14 maj 2013.

- Më datë 16 mars 2017, u miratua Rregullorja (BE) nr. 2017/459 e Komisionit, “Për krijimin e Kodit të Rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit” dhe për shfuqizimin e Rregullores (BE) nr. 984/2013. Kjo rregullore (në vijim: CAM NC) vendos kuadrin rregullator për mekanizmat e alokimit të kapacitetit në sistemet e transmetimit të gazit, duke përfshirë si kapacitetin ekzistues, ashtu edhe atë shtesë (në rritje).

- “Udhëzuesi për Testimin e Tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik 2023”, i paraqitur nga TAP AG më datë 6 qershor 2023, u miratua nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 212, datë 27.06.2023.

- Më datë 16 qershor 2025, në përputhje me paragrafin 4.1.7 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, TAP AG i paraqiti Autoriteteve dokumentin “Udhëzuesi për Testimin e Tregut të Gazsjellësit Trans Adriatik “ (në vijim: “Udhëzimet 2025”).

Dhe, duke patur parasysh se:

- Udhëzimet e propozuara, siç përmendet më sipër, janë në përputhje me parimet e përcaktuara në Opinionin Përfundimtar të Përbashkët, në Kodin e Rrjetit për Mekanizmat e Alokimit të Kapacitetit (CAM NC), si dhe me kuadrin ligjor kombëtar, dhe nuk përmbajnë pengesa të panevojshme për realizimin e procesit të ndërtimit të kapaciteteve shtesë.;

- Procesi është konceptuar në mënyrë që të lehtësojë bashkëpunimin me operatorët e sistemeve të transmetimit (OST) të vendeve fqinje, me synimin për të siguruar një zhvillim të koordinuar të rrjetit dhe për të shmangur mospërputhjet e mundshme në ndërtimin e kapaciteteve ndërkufitare; .

- Dokumenti me datë 16 qershor 2025, i cili përmban “Udhëzimet 2025 e Testimit të Tregut” (Shtojca B) për ekzaminimin e ofertave të reja të mundshme për kapacitet në rritje, u dërgua nga TAP AG për miratim nga Autoritetet.

- Autoritetet, pas shqyrtimit të “Udhëzimit për Testimin e Tregut 2025”, i cili në thelb bazohet në të njëjtat parime të zbatuara gjatë Testimit të Tregut 2023, hartuan në mënyrë të përbashkët një dokument që përmban vendimin për miratimin e udhëzimeve dhe arsyet përkatëse (Shtojca A e këtij vendimi).

- Dokumenti i përbashkët është gjithashtu objekt miratimi nga autoritetet rregullatore të Italisë dhe Greqisë, përkatësisht ARERA dhe RAE.

- Procedura e Testimit të Tregut 2025, e propozuar nga TAP AG, është në përputhje me parimet e përcaktuara në Opinionin Përfundimtar të Përbashkët, si dhe me direktivat dhe rregulloret përkatëse të Bashkimit Evropian që rregullojnë alokimin e kapacitetit ekzistues dhe shtesë në sistemet e transmetimit të gazit.

- Nevoja për miratimin e dokumentit të përbashkët që miraton “Udhëzimet për Testimin e Tregut 2025” (Shtojca A).

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë “*Udhëzimet për Testimin e Tregut 2025 për Gazsjellësin Trans Adriatik* “, të paraqitur nga TAP AG më datë 16 qershor 2025 (Shtojca B), si dhe të japë miratimin për përfshirjen në vendimin e përbashkët me autoritetet rregullatore të Italisë (ARERA) dhe Greqisë (RAE) (Shtojca A).

2. Të dërgohet një kopje të këtij vendimi Autoriteteve Rregullatore ARERA dhe RAE, shoqërisë TAP AG; si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Të publikojë këtë vendim në Fletoren zyrtare përfshirë shtojcat A dhe B.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

Autorità di regolazione per energia, reti e ambiente (ARERA, Itali)

Enti Rregullator i Energjise (ERE, Shqipëri)

Ρυθμιστική Αρχή Αποβλήτων, Ενέργειας και Υδάτων (RAAEY , Greqi)

Miratimi i "Udhëzimeve për Testimin e Tregut" për Gazsjellësin Trans Adriatik”

Propozuar nga TAP AG më 16 Qershor 2025

Ndërsa ¹:

Më 29 gusht ²⁰¹¹, TAP AG i paraqiti Ministrisë Italiane të Zhvillimit Ekonomik dhe më 31 gusht ²⁰¹¹, Autoritetit Rregullator të Energjisë së Greqisë (RAE) një "Kërkesë Përfundimtare për Gazsjellësin Trans Adriatik", në përputhje me nenin 36 të Direktivës së Gazit 2009/73/EC. Më datë 1 shtator 2011, TAP AG i paraqiti një kërkesë të tillë edhe Entit Rregullator të Energjisë (ERE) të Shqipërisë, në përputhje me nenin 22 të Direktivës së mëparshme për Gazin, 2003/55/EC.

Në qershor 2013, Ministria Italiane, RAE dhe ERE morën vendimin për përjashtimin, duke miratuar *Opinionin e Përbashkët* (në vijim: "FJO"), një dokument i përgatitur në mënyrë të përbashkët nga ARERA, ERE dhe RAE (në vijim: "Autoritetet"), i cili më pas u amendua për t'u përshtatur me Vendimin e Komisionit Evropian [C(2013)2949 final], datë 16 maj 2013, si dhe për të reflektuar Opinionin nr. 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 14 maj 2013.

Në dokumentin e sipërcituar, TAP AG-së i është dhënë një përjashtim nga zbatimi i dispozitave të neneve 9 (Shkëputja), 32 (Aksesi i Palëve të Treta) për Kapacitetin Fillestar prej 10 miliardë metra kub në vit, si dhe të neneve 41(6), 41(8) dhe 41(10) (Tarifat e Rregulluara) të Direktivës së Gazit 2009/73/EC, për një periudhë 25-vjeçare duke filluar nga Data e Fillimit të Operimeve Tregtare (Commercial Operation Date – COD), në përputhje me kushtet e përcaktuara në Opinionin Përfundimtar të Përbashkët (FJO).

Ndër të tjera, sipas nenit 4.1.7 të FJO-së, TAP AG është i detyruar të kryejë Teste të Tregut rregullisht, duke filluar jo më vonë se nga COD, dhe më pas, të paktën një herë në çdo dy vjet. TAP AG duhet t'i zhvillojë këto Teste të Tregut në përputhje me udhëzimet e miratuara nga Autoritetet rregullatore, me qëllim mundësimin e aksesit në kapacitetet shtesë të disponueshëm, deri në Kapacitetin Total prej 20 miliardë metra kub në vit.

Në përputhje me nenin 4.1.7 të FJO-së, TAP AG është i detyruar të përmbushë kërkesat detyruese për kapacitet që rezultojnë nga çdo Test Tregu, duke marrë në konsideratë dispozitat e pikave 2, 6 dhe 9 të seksionit 4.7 të FJO-së. Zgjerimi i kapacitetit do të realizohet vetëm nëse konsiderohet ekonomikisht i qëndrueshëm, domethënë nëse të ardhurat shtesë nga kapaciteti i kërkuar si rezultat i Testit të Tregut janë të barabarta ose tejkalojnë kostot shtesë efikase, të përcaktuara sipas metodologjisë së TAP AG, siç parashikohet në Kodin Tarifor të TAP-it.

U përcaktuan gjithashtu kushte shtesë për të garantuar përputhshmërinë e plotë me kriteret e nenit 36(1) të Direktivës së Gazit, duke përfshirë, ndër të tjera, detyrimin e TAP AG për të ndërtuar pika shtesë të hyrjes dhe/ose daljes në territorin e Greqisë dhe Shqipërisë, me kërkesë të një pale të tretë, në kuadër të një Testi Tregu, për aq kohë sa një ndërtim i tillë është teknikisht i realizueshëm. Barra e provës për të demonstruar se ndërtimi nuk është

¹Më poshtë zbatohen përkufizimet e *Opinionit të Përbashkët Përfundimtar* dhe të Rregullores së BE-së 2017/459.

teknikisht i mundshëm i takon TAP AG. Nëse kërkohet nga Autoritetet, TAP AG është i detyruar të paraqesë një vlerësim të pavarur teknik nga një palë e tretë e certifikuar. Të gjitha kostot që lidhen me ndërtimin dhe funksionimin e pikave të tilla shtesë do të mbulohen nga pala e tretë aplikante, në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës. Kostot që lidhen me këto pika nuk do të përfshijnë investimet që rrjedhin nga zgjerimi i kapacitetit në kuptim të nenit 4.1 të FJO-së, të cilat do të rikuperohen përmes mekanizmit tarifor të TAP-it.

Më 16 mars ²⁰¹⁷ u miratua Rregullorja (BE) 2017/459 e Komisionit “për krijimin e një Kodi Rrjeti mbi Mekanizmat e Ndarjes së Kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit dhe për shfuqizimin e Rregullores (BE) nr. 984/2013”. Rregullorja 2017/459, e njohur si “CAM NC” (Capacity Allocation Mechanisms Network Code), vendos rregulla të harmonizuara për ndarjen e kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit natyror, duke përfshirë si kapacitetin ekzistues ashtu edhe atë rritës.

Më 14 qershor ²⁰¹⁹, TAP AG i paraqiti Autoriteteve “*Udhëzimet për Testin e Tregut 2019*”, me qëllim përafrimin e dispozitave përkatëse të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar (FJO) me Rregulloren (BE) 2017/459, veçanërisht në drejtim të koordinimit të afateve dhe forcimit të bashkëpunimit me Operatorët e Sistemit të Transmetimit (OST) fqinjë. Pas miratimit nga Autoritetet, TAP AG nisi, në bashkërendim me OST-të përkatëse, Testin e parë të Tregut për identifikimin e kapacitetit rritës më 5 korrik 2019. Gjatë fazës detyruese të këtij procesi, nuk u paraqit asnjë ofertë detyruese nga transportuesit.

Më 11 qershor ²⁰²¹, TAP AG i paraqiti Autoriteteve “*Udhëzimet për Testin e Tregut 2021 të Gazsjellësit Trans Adriatik*”. Pas miratimit nga Autoritetet, TAP AG, në bashkëpunim me Operatorët e Sistemit të Transmetimit (OST) fqinjë, nisi në korrik 2021 Testin e dytë të Tregut për vlerësimin e kapacitetit të mundshëm zgjerues (rritës) (në vijim “Testi i Tregut 2021”). Vlerësimi i rezultateve të këtij testi (“Vlerësimi T”) pasoi më tej në përputhje me kuadrin rregullator përkatës.

Në fazën e miratimit të Propozimit të Projektit nga Autoritetet, tre Operatorët e Sistemit të Transmetimit (SRG, TAP AG dhe DESFA), duke marrë parasysh zhvillimet e fundit në tregun e gazit, sugjeruan që Testi i Tregut 2021 të zhvillohej në dy raunde të fazës detyruese: raundi i parë në janar 2023 dhe, nëse do të vlerësohej i nevojshëm në bazë të rezultateve të këtij raundi, raundi i dytë gjatë vitit 2023.

Faza e parë e lidhjes u përmbyll në shkurt 2023 me alokimin e kapacitetit dhe nënshkrimin e Marrëveshjeve të Përgjithshme të Transportit (GTA). Si rezultat i kësaj faze, u përcaktua Niveli 1 i kapacitetit, në përputhje me Propozimin e Projektit të miratuar nga Autoritetet në nëntor 2022. Faza e dytë e lidhjes përfundoi më 31 janar 2024, pa alokime të mëtejshme kapaciteti.

Më 16 qershor ²⁰²⁵, në përputhje me Seksionin 4.1.7 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar, TAP AG u paraqiti Autoriteteve " Udhëzimet për Testin e Tregut 2025 të Gazsjellësit Trans Adriatik" (në vijim: Udhëzimet 2025).

Pikat kryesore të Udhëzimeve të propozuara 2025 janë:

1. Procesi ndahet në dy faza: një faza jo-detyruese, e cila përfshin vlerësimin e kërkesës dhe projektimin e mundshëm të zgjerimit, dhe faza detyruese, që përfshin një periudhë informimi dhe më pas fazën e ofertimit detyrues, në përputhje me përcaktimet e Rregullores CAM NC.
2. procedura është e hapur për të gjitha palët e Interesuara, përkatësisht për çdo person juridik që shpreh interes për të paraqitur tregues jo-detyruese të kërkesës për kapacitet pranë -it dhe për të marrë pjesë në Testin e Tregut të TAP-it në mënyrë të hapur, transparente dhe jo-diskriminuese.;
3. gjatë Testit të Tregut, të gjitha Palët e Interesuara mund të kërkojnë zgjerim të kapacitetit të hyrjes dhe/ose daljes në Sistemin e Transportit TAP, si dhe ndërtimin e pikave të reja të hyrjes dhe/ose daljes përgjatë sistemit të transportit të TAP;
4. Palët e interesuara janë përgjegjëse për të siguruar që Ofertat e tyre Detyruese të jenë në përputhje në përputhje me çdo kufizim të zbatueshëm të kapacitetit, sipas përcaktimeve të FJO-së. Për këtë qëllim, aplikantët duhet t'i paraqesin TAP-it dhe Autoriteteve informacionin përkatës në lidhje me Ofertën Detyruese të dorëzuar, si dhe çdo informacion shtesë që mund të kërkohej nga Autoritetet. Detajet mbi mënyrën e komunikimit dhe ndërveprimit për qëllimet e këtij vlerësimi do të specifikohen në Njoftimin e Fazës Detyruese dhe në Projektin përkatës.;
5. Palët e interesuara që i paraqesin TAP-it treguesit jo-detyruese të kërkesës kanë përgjegjësinë të paraqesin çdo tregues përkatës jo-detyrues të kërkesës te OST-të përkatëse fqinje sipas rregullave CAM NC, ose të sigurojnë kapacitetin e interkonjeksionit sipas procedurave përkatëse në vendet jo-anëtare të BE-së;
6. Raporti i Vlerësimit të Kërkesës (DAR) është zhvilluar dhe publikuar ²së bashku me TSO-të fqinje të BE-së dhe do të përfshijë kërkesën e ardhshme për zgjerim në pikat e ndërlidhjes. Raportet do të ndërtohen mbi modelin e zhvilluar nga ENTSG;
7. për të siguruar një pjesëmarrje kuptimplote në fazën jo-detyruese të testimit të tregut, një *Tarifa e Pjesëmarrjes* prej 10,000 EUR paguhet nga çdo Palë e Interesuar që dëshiron të marrë pjesë në Testin e Tregut. Tarifa e pjesëmarrjes u rimbursohet palëve përkatëse të interesuara pas një testi të suksesshëm të qëndrueshmërisë ekonomike dhe nënshkrimit të të paktën një Marrëveshjeje të Transportit të Gazit me çdo përdorues;
8. TAP mund të kërkojë tarifa edhe për kryerjen e studimeve teknike të nevojshme nga Kërkesat jo-detyruese për Kapacitet dhe Lidhje (p.sh. për të përcaktuar fizibilitetin teknik të një lidhjeje përpara një Faze Detyruese ose në lidhje me një datë të hershme

²Koha e prituri për publikim është fundi i janarit 2026. Koha e saktë varet nga publikimi i çdo alokimi kapaciteti sipas Fazës Detyruese të Testit të Tregut 2023.

fillimi të kapacitetit që kërkon investim përpara përfundimit të një Faze Detyruese ose në lidhje me kërkesën që tejkalon Kapacitetin Total të TAP-it, siç referohet në seksionin 4.1.9 të FJO-së). Modalitetet e tarifave të tilla bien dakord veçmas me Autoritetet përkatëse, publikohen në faqen e internetit të TAP-it dhe u komunikohen Palëve të Interesuara përkatëse;

9. Udhëzimet e vitit 2025 sigurojnë koordinimin me Testin e Tregut të vitit 2023 që është në vazhdim, prandaj (i) asnjë fazë detyruese nuk do të fillojë para mbylljes së fazës detyruese të vitit 2023 dhe (ii) pas publikimit të ndarjes së kapacitetit sipas Fazës Detyruese të Testit të Tregut të vitit 2023, të gjitha Palëve të Interesuara nga Faza Jo-Detyruese do t'u jepet mundësia të rishikojnë Treguesit e tyre të Kërkesës Jo-Detyruese;

Ndërsa:

- e propozuara 2025, siç janë përmbledhur më sipër, janë në përputhje me parimet e deklaruar në Opinionin e Përbashkët Përfundimtar, në CAM NC, në të gjitha legjislacionet kombëtare, dhe nuk paraqesin pengesa të panevojshme në procesin e parashikuar për ndërtimin e kapaciteteve shtesë;
- Procesi është hartuar në një mënyrë që lehtëson bashkëpunimin me OST-të fqinje, me qëllim sigurimin e një zhvillimi të koordinuar të rrjetit, duke shmangur mospërputhjet e mundshme në ndërtimin e kapacitetit ndërkufitar;
- e propozuara të vitit 2025 marrin në konsideratë nevojën për të siguruar koordinimin e duhur me Testin e Tregut të vitit 2025, i cili është ende i hapur;

Autoritetet së bashku

miratojnë "*Udhëzimet për Testin e Tregut 2025 të Gazsjellësit Trans Adriatik* ", dokumentin e paraqitur nga TAP AG dhe të bashkëngjitur si SHTOJCA B.

Autorità di regolazione per energia, reti e ambiente (ARERA, Italy)

Enti Rregullator i Energjise (ERE, Albania)

Ρυθμιστική Αρχή Αποβλήτων, Ενέργειας και Υδάτων (RAAEY, Greece)

Approval of “Market Test Guidelines for Trans Adriatic Pipeline”

Proposed by TAP AG on the 16th of June 2025

Whereas¹:

On August 29th 2011 TAP AG submitted to the Italian Ministry of Economic Development and on August 31st 2011 to the Regulatory Authority for Energy of Greece (RAE) an “Exemption Application for Trans Adriatic Pipeline”, as foreseen by Article 36 of the Gas Directive 2009/73/EC. On September 1st 2011 TAP AG submitted to the Energy Regulatory Entity (ERE) of Albania an “Exemption Application for Trans Adriatic Pipeline”, in accordance with Article 22 of the Gas Directive 2003/55/EC.

In June 2013 the Italian Ministry, RAE and ERE took the decision on the exemption, adopting the *Final Joint Opinion* (hereafter: “the FJO”), a document jointly written by ARERA, ERE and RAE (hereafter: “the Authorities”) and amended to comply with the Commission Decision [C(2013)2949 final] dated 16th of May 2013 and to take note of the Opinion 1/2013 of the Energy Community Secretariat dated 14th of May 2013.

In the aforementioned document an exemption from the provisions of Articles 9 (Unbundling), 32 (TPA) for the Initial Capacity of 10bcm/y, and 41.6, 41.8, 41.10 (Regulated Tariffs) of the Gas Directive has been granted to TAP AG for a period of 25 years starting from the beginning of the Commercial Operation Date, under several conditions. Among others, according to Article 4.1.7 of the FJO, TAP AG is obliged to perform Market Tests on a regular basis starting no later than the Commercial Operation Date and, subsequently, at least every two years. TAP AG has to perform the Market Tests under guidelines to be approved by the Authorities, with the view to offer to all Interested Parties additional available capacity up to the Total Capacity of 20bcm/y².

Following Article 4.1.7, TAP AG is obliged to fulfil the binding capacity requests resulting from each market test taking into account the provisions of points 2, 6 and 9 of §4.7 of the FJO. The expansion takes place if it is economically viable, namely if the incremental revenues from capacity resulting from each market test are equal or larger than the efficient incremental costs, quantified according to the TAP methodology as laid down in the TAP Tariff Code.

Additional terms to safeguard full compliance to the criteria of Article 36.1 of the Gas Directive were also imposed, among others the obligation to build additional entry and exit points in Greece and Albania upon request of a third party, as a result of any market test, as long as such construction is technically feasible. The burden of proof to demonstrate that the construction of such additional entry and exit point is not technically feasible rests with TAP AG. If so requested by the Authorities, TAP AG is to provide an opinion from an independent third party. All costs related to the construction and operation of such entry and exit points will be borne by the third party who made the

¹ Hereafter the definitions of the *Final Joint Opinion* and of EU Regulation 2017/459 apply.

² Following Article 4.1.9, the possibility to further expand capacity beyond the Total Capacity, (i.e. beyond 20 bcm/year), shall be investigated by TAP AG and if economically and technically feasible, it will be undertaken, with a view to fulfil all requests for long-term capacity (long-term means here a duration of more than 15 years).

request, according to the national legislation in place at the time of the request. Costs related to such entry and exit points will not include the investments required for additional capacity of TAP, resulting from §4.1 of the FJO, which will be remunerated through TAP Tariffs;

On March 16th 2017, the new EU Regulation 459/2017 “establishing a network code on capacity allocation mechanisms in gas transmission systems and repealing Regulation (EU) No 984/2013” was adopted. The EU Regulation 2017/459 (hereafter: CAM NC) establishes a Network Code setting up capacity allocation mechanisms in gas transmission systems for both existing and incremental capacity.

On June 14th 2019, TAP AG submitted to the Authorities the “*Guidelines for the 2019 Market Test*” seeking to align the related provisions of the Final Joint Opinion with EU Regulation 2017/459, in particular by coordinating the expected timeline/deadlines and by strengthening the cooperation with adjacent TSOs. Following the approval of the Authorities, TAP AG launched, in coordination with adjacent TSOs, the first Market Test for expansion (incremental) capacity on July 5th 2019. During the binding phase, shippers did not submit any binding bids.

On June 11st 2021, TAP AG submitted to the Authorities the “*Guidelines for the 2021 Market Test of Trans Adriatic Pipeline*”. Following the approval of the Authorities, TAP AG launched, in coordination with adjacent TSOs, the second Market Test for expansion (incremental) capacity on July 2021 (hereafter: 2021 Market Test).

At the stage of the Project Proposal approval by the Authorities, the three TSOs (SRG, TAP AG and DESFA) considering the recent gas market developments suggested that the 2021 Market Test could be performed in two rounds of binding phases: a first one in January 2023 and a second one, if needed on the basis of the results of the first binding phase, during 2023.

The first binding phase was concluded on February 2023 with the allocation of capacity and the signature of GTAs. As a result of the first binding phase, the Level 1 of capacity (as defined in the Project Proposal approved by the Authorities in November 2022) was assigned. The second binding phase was concluded the 31 January 2024 with no further allocation of capacity.

The third joint procedure of incremental capacity was initiated in 2023 and the binding phase is expected to be concluded end of 2025. The delay is due to uncertainties related to Article 2 of Apulia Region n. 28/2022 that is likely to have negative impact on the economic viability test of the project, foreseen at Article 22 of the CAM NC.

On June 16th 2025, in compliance with Section 4.1.7 of the Final Joint Opinion, TAP AG submitted to the Authorities the “*Guidelines for the 2025 Market Test of Trans Adriatic Pipeline*” (hereafter: *Guidelines 2025*).

The main points of the proposed Guidelines 2025 are:

1. the process is split into two phases, a *non-binding phase* (that includes the demand assessment and the design of expansion) and a *binding phase* (that includes an information period and a binding bidding phase) as described also in CAM NC;
2. the procedure is open to all Interested Parties, namely any legal person who is interested in submitting non-binding capacity demand indications to TAP and to participate in TAP's Market Test in a transparent and non-discriminatory manner;
3. during the Market Test, all Interested Parties can request expansion of the entry and/or of the exit capacity on the TAP Transportation System, as well the construction of new entry and/or exit points along TAP's transportation system;
4. interested Parties are responsible to ensure that their Binding Bids comply with any applicable Capacity Cap according to the FJO. To this end, applicants shall provide to TAP AG and the Authorities the information relating to the Binding Bid made to TAP, as well as any other information that the Authorities may request (the details of the communications and interaction for the purposes of this evaluation will be inserted in the Binding Phase Notice and in the Project Proposal);
5. Interested Parties who submit the non-binding demand indications to TAP have the responsibility to submit any corresponding non-binding demand indications to relevant adjacent TSOs according to CAM NC rules, or to procure the interconnection capacity according to relevant procedures in non-EU countries;
6. the Demand Assessment Report (DAR) is developed and published³ jointly with Adjacent EU TSOs and it will include the prospective demand for expansion at the interconnection points. The reports will be built on the template developed by ENTSOG;
7. to ensure a meaningful participation to the non-binding phase of the market test, a *Participation Fee* of 10,000 EUR is payable by each Interested Party wishing to participate in the Market Test. The participation fee is reimbursed to the respective interested parties following a successful economic viability test and execution of at least one Gas Transportation Agreement with any user;
8. TAP may request fees also for the performance of technical studies necessitated by the non-binding Capacity and Connection Requests (e.g. to establish technical feasibility of a connection ahead of a Binding Phase or related to an early start-up date of capacity requiring investment ahead of the completion of a Binding Phase or related to demand in excess of TAP's Total Capacity, as referenced in section 4.1.9 of the FJO). Modalities of such fees are separately agreed with relevant Authorities, published on TAP's website and communicated to relevant Interested Parties;

³ Expected timing for publication is end January 2026. The precise timing depends on the publication of any capacity allocation under the Binding Phase of the 2023 Market Test.

9. the Guidelines 2025 ensure the coordination with the ongoing 2023 Market Test, therefore (i) non binding phase will be started before the closure of the 2023 binding phase and (ii) following the publication of the capacity allocation under the Binding Phase of the 2023 Market Test, all Interested Parties from the Non-Binding Phase will be given the opportunity to revise their Non-Binding Demand Indications; Whereas:
- the proposed *Guidelines 2025*, as summarized above, are in line with the principles stated in the Final Joint Opinion, in CAM NC, in all national legislations, and do not introduce undue barriers to the foreseen process for building incremental capacity;
 - the process is designed in a way that facilitates the cooperation with adjacent TSOs, with the aim of ensuring a coordinated development of the network, avoiding possible mismatch in the building of cross border capacity;
 - the proposed *Guidelines 2025* consider the need of ensuring the proper coordination with the still open 2025 Market Test;

the Authorities jointly

- approve the “*Guidelines for the 2025 Market Test of Trans Adriatic Pipeline*” submitted document proposed by TAP AG and attached as ANNEX B.

Udhëzime për Testimin e Tregut 2025 nga Gazsjellësi Trans Adriatik AG (TAP AG)

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje
2. Përkuftizime
3. Faza 7
4. Faza 9
5. Faza e Lidhjes
6. Mohim përgjegjësie
7. Dokumentacion mbështetës

1. Hyrje

Qëllimi i këtyre "Udhëzimeve për Testimin e Tregut 2025" të Gazsjellësit Trans Adriatik (në vijim: "Udhëzimet") është të përcaktojë rregullat dhe procedurat që do të ndiqen gjatë procesit të Testimit të Tregut, i cili do të zhvillohet nga TAP duke filluar nga muaji korrik 2025, si dhe të informojë të gjitha Palët e Interesuara dhe çdo palë tjetër përkatëse për këtë proces. Gjatë Testimit të Tregut të TAP-it, Palët e Interesuara do të kenë mundësinë të paraqesin: (i) kërkesa për kapacitet shtesë në pikat ekzistuese të hyrjes dhe/ose daljes përgjatë sistemit të transportit të TAP-it ("Kërkesat për Kapacitet"); dhe/ose (ii) kërkesa për ndërtimin e pikave të reja të hyrjes dhe/ose daljes ("Kërkesat për Lidhje").

Këto Udhëzime pasqyrojnë regjimin specifik rregullator të zbatuar ndaj TAP AG për realizimin e Testimeve të Tregut. Ato synojnë të harmonizojnë dispozitat e Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Autoriteteve Rregullatore për Kërkesën për Përrjashtim të paraqitur nga TAP AG, të datës 6 qershor 2013 ("FJO"), të dhënë në përputhje me Direktivën 2009/73/EC, si dhe dispozitat e Kodit Tarifor të TAP-it, me Rregulloren (BE) nr. 2017/459 të Komisionit, e cila përcakton Kodin e Rrjetit për Mekanizmat e Alokimit të Kapacitetit në sistemet e transmetimit të gazit ("CAM NC").

Në përputhje me Seksionin 4.1.7 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët (FJO), këto Udhëzime janë miratuar nga autoritetet rregullatore kombëtare kompetente të Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë (në vijim: "Autoritetet"), përkatësisht ARERA, RAAEY dhe ERE. Në rast se Testi i Tregut kalon në Fazën Detyruese, këto Udhëzime pritet të shoqërohen me Propozim(et) për Projektin, të cilat do të jenë subjekt miratimi nga Autoritetet.

1.1 Kërkesa për të zgjeruar kapacitetin


Për kapacitetin e tij fillestar, TAP përfiton nga një përjashtim nga dispozitat që lidhen me aksesin e palëve të treta, tarifat e rregulluara dhe ndarjen e pronësisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Opinionin Përfundimtar të Përbashkët (FJO). Përjashtimi nga tarifat e rregulluara dhe ndarja e pronësisë aplikohet gjithashtu edhe për kapacitetin e zgjerimit të TAP-it.

Në zbatim të FJO-së, TAP ka detyrimin të kryejë një Test Tregu të paktën çdo dy vjet, duke filluar jo më vonë se Data e Fillimit të Operimit Komercial ("COD"), me qëllim vënien në dispozicion të kapacitetit shtesë përtej kapacitetit fillestar, si dhe të çdo pjese të kapacitetit të zgjerimit të ndarë si rezultat i fazës (ose fazave) detyruese të Testeve të Tregut të mëparshme.

1.2 Testi i Tregut

Testi i Tregut përbën një procedurë të hapur, transparente dhe jo-diskriminuese. Ky proces zhvillohet në përputhje me kuadrin rregullator unik dhe specifik që i është aplikuar TAP-it. Një përmbledhje e fazave të Testit të Tregut është paraqitur në Figurën 1 më poshtë.

Figure 1: Overview of the Market Test



Afatet kryesore të zbatueshme për Fazën Jo-Detyruese të Testit të Tregut të TAP-it për vitin 2025 janë si më poshtë:

TAP nis Fazën Jo-Detyruese	7 korrik 2025
Palët e interesuara dorëzojnë Formularin e Regjistrimit dhe të Treguesit të Kërkesës Jo-detyruese	7 korrik – 1 shtator 2025 ¹
TAP dhe OST-të fqinje publikojnë raportin/raportet e vlerësimit të kërkesës	Afati i pritur përfundon në janar 2026. Afati i saktë varet nga publikimi i çdo alokimi kapaciteti sipas Fazës Detyruese të Testit të Tregut 2023. ² Pas një publikimi të tillë, të gjitha Palëve të Interesuara nga Faza Jo-Detyruese do t'u jepet mundësia të rishikojnë Treguesit e tyre Jo-Detyrues të Kërkesës. Palët e Interesuara do të informohen për afatin e saktë për një rishikim të tillë me një njoftim prej të paktën dy javësh. ³
Fillimi i Fazës së Projektimit të Koordinuar	Për t'u përcaktuar (menjëherë pas publikimit të një Raporti të Vlerësimit të Kërkesës (DAR) duke përfshirë një vendim për të vazhduar)
TAP dhe OST-të fqinje publikojnë draftin e propozimit të projektit për konsultim publik	Për t'u përcaktuar (jo më vonë se 12 javë pas fillimit të Fazës së Projektimit të Koordinuar)

¹TAP rezervon të drejtën për të pranuar treguesit jo-detyruese të kërkesës të dërguara pas afatit prej 8 javësh. Përveç kësaj, duke pasur parasysh Fazën Detyruese të Testit të Tregut 2023, të gjitha palët e interesuara nga faza jo-detyruese do të kenë mundësinë të rishikojnë treguesit e tyre jo-detyruese të kërkesës.

²Një publikim i tillë do të përfshinte gjithashtu një situatë ku TAP informon tregun se nuk janë marrë oferta të detyrueshme ose regjistrime për Fazën e Ofertave të Detyrueshme.

³Vini re se për Pikat e Ndërlidhjes të cilat nuk ofrohen për rezervim në Fazën Detyruese të Testit të Tregut 2023, Raporti(et) i Vlerësimit të Kërkesës mund të lëshohen veçmas në një fazë më të hershme dhe pa një ditare për të rishikuar Treguesit Jo-Detyrues të Kërkesës për një Pikë të tillë Ndërlidhjeje.

Përditësim mbi afatin kohor dhe procesin e Testit të Tregut 2025

Propozimi i Projektit për Fazën Detyruese të Testit të Tregut 2023, që pritet të paraqitet për miratim të Autoritetet Italiane, Greke dhe Shqiptare në korrik 2025, përmban një afat kohor në seksionin D1 " **Afati Kohor i Fazës Detyruese** " ⁴, që parashikon një Fazë Detyruese të Ofertave në fund të vitit 2025.

Afati kohor tregues i Testit të Tregut 2025 i përfshirë në këto Udhëzime synon të zbusë çdo pasojë të mundshme negative të testeve të tregut që mbivendosen duke finalizuar DAR vetëm pasi të jetë kryer ndarja e kapacitetit sipas Fazës Detyruese të Testit të Tregut 2023.

Pasi të jenë publikuar rezultatet e ndarjes së kapacitetit nga Faza Detyruese e Testit të Tregut 2023, TAP do t'u japë mundësinë të gjitha Palëve të Interesuara nga faza Jo-Detyruese të rishikojnë Treguesit e tyre të Kërkesës Jo-Detyruese brenda të paktën 2 (dy) javësh nga publikimi.

Në çdo rast, TAP rezervon të drejtat e tij për të pranuar Tregues Kërkese Jo-Detyrues të dërguar pas afatit prej 8 javësh, sipas sa më sipër.

Në këtë mënyrë, TAP parashikon të sigurojë që Faza e Projektimit të Koordinuar të jetë e përshtatur posaçërisht për Treguesit e Kërkesës Jo-Detyruese të mbetura për kapacitet shtesë, pasi kapaciteti të jetë ndarë në Fazën Detyruese të Testit të Tregut 2023. Kur të publikohet, DAR do të përmbajë një vendim nëse do të fillojë një Fazë e Projektimit të Koordinuar për Testin e Tregut 2025 apo jo.

Duke pasur parasysh këtë afat kohor fleksibël për Testin e Tregut 2025, TAP do ta mbajë tregun dhe palët e interesuara përkatëse të informuara mbi hapjen e Fazës Detyruese të Testit të Tregut 2023 duke publikuar informacion në faqen e saj të internetit dhe duke publikuar Propozimin e Projektit kur t'i paraqitet Autoriteteve për miratim.

Si rezultat i Testit të Tregut, kërkesat detyruese për kapacitet afatgjatë të firmës së përparshme mund të çojnë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në FJO, Kodin Tarifor të TAP-it dhe legjislacionin përkatës të zbatueshëm për TAP-in, në një detyrim për investim nga ana e TAP-it, në përputhje me Seksionin 4.1.8 të FJO-së.

Në rast se paraqitet një situatë e parashikuar nga Seksioni 4.1.9 i FJO-së, TAP do të angazhohet në diskutime me Autoritetet lidhur me fizibilitetin ekonomik dhe teknik të mundësive të tilla të zgjerimit përtej Kapacitetit Total, si dhe mbi proceset dhe procedurat përkatëse për zbatimin e tyre.

Përveç trajtimit të kapacitetit shtesë në pikat ekzistuese të ndërlidhjes së TAP-it, këto Udhëzime përcaktojnë kuadrin e përgjithshëm për trajtimin e Kërkesave për Lidhje që synojnë ndërtimin e pikave të reja të hyrjes dhe/ose daljes në territorin e Greqisë, në përputhje me Seksionin 4.7.5 të FJO-së, si dhe kërkesave për rritjen e kapacitetit teknik të pikave ekzistuese dhe/ose ndërtimin e pikave shtesë të hyrjes dhe/ose daljes në territorin e Shqipërisë, në përputhje me Seksionin 4.7.8 të FJO-së. Për të marrë në shqyrtim këto Kërkesa për Lidhje, të gjitha kostot përkatëse duhet të mbulohen nga pala kërkuese.

Këto Udhëzime përmbajnë parimet bazë që rregullojnë procedurën e paraqitjes së një Kërkese për Lidhje drejtuar TAP-it. Procedura të mëtejshme të detajuara mund të zhvillohen dhe miratohen në një fazë të mëvonshme, për publikim të veçantë.

⁴ <https://www.tap-aq.com/shippers/market-tests-7>

2. Përkufizime

Ky kapitull përmban përkufizimet dhe terminologjinë e përdorur në këto Udhëzime. Çdo term i shkruar me shkronjë të madhe i përdorur, por që nuk është përcaktuar këtu, do të ketë kuptimet e dhëna në Opinionin e Përbashkët Përfundimtar ose në Kodin Tarifor të TAP-it.

OST ngjitur do të thotë një OST që ndan një pikë ndërlidhjeje me TAP-in dhe zbaton legjislacionin e BE-së për energjinë, duke përfshirë DESFA-n, ICGB-në, Albغاز-in dhe Snam Rete Gas.

Aplikanti do të thotë pala e interesuar që regjistrohet në një Fazë Detyruese sipas këtij Testi të Tregut.

Autoritetet do të thotë Autoritetet Kombëtare Rregullatore të Energjisë të Italisë ('ARERA'), Greqisë ('RAAEY') dhe Shqipërisë ('ERE').

Ofertë e Detyrueshme do të thotë një ofertë e paraqitur nga një Aplikant gjatë Fazës së Ofertimit të Detyrueshëm.

Faza Detyruese do të thotë faza e përgjithshme e Testit të Tregut e cila përbëhet nga Faza e Informacionit dhe Faza e Ofertimit Detyrues.

Faza e Ofertimit të Detyrueshëm do të thotë faza përfundimtare e Testit të Tregut, ku Palët e Interesuara mund të paraqesin Oferta të Detyrueshme të TAP dhe gjatë së cilës TAP do të kryejë Testin e Qëndrueshmërisë Ekonomike dhe do të vazhdojë me ndarjen e kapacitetit.

Kufizimet e Kapacitetit do të thotë masat pro-konkurrese për tregun italian, grek dhe shqiptar, siç përcaktohen në pikat 3, 6 dhe 9 të seksionit 4.7 të FJO-së.

Kërkesë për Kapacitet do të thotë një kërkesë detyruese dhe/ose jo detyruese drejtuar TAP-it nga një Palë e Interesuar për të blerë kapacitet afatgjatë të qëndrueshëm në pikat e hyrjes dhe/ose daljes së TAP-it.

Kërkesë për Lidhje do të thotë një kërkesë jo-detyruese drejtuar TAP-it nga një Palë e Interesuar për të ndërtuar një pikë të re hyrjeje dhe/ose daljeje në Shqipëri ose Greqi dhe/ose për të rritur kapacitetin teknik të një pike hyrëse dhe/ose daljeje ekzistuese në Shqipëri, në përputhje me Seksionet 4.7.5 dhe 4.7.8 të FJO-së.

Faza e Projektimit të Koordinuar do të thotë pjesa e dytë e Fazës Jo-Obliguese të këtij Testi të Tregut.

Faza e Vlerësimit të Kërkesës do të thotë pjesa e parë e Fazës Jo-Obliguese të këtij Testi të Tregut.

Raporti i Vlerësimit të Kërkesës (RVK) do të thotë dokumenti i përgatitur nga TAP dhe OST-të fqinje që vlerëson kërkesën e mundshme për zgjerim .

Kapaciteti i Zgjerimit do të thotë kapaciteti në sistemin e transportit TAP i vënë në dispozicion përveç Kapacitetit Fillestar, siç referohet në FJO.

Kapaciteti Afatgjatë i Firmës së Përparshme do të thotë Produkte Kapaciteti për kapacitetin e transportit në sistemin e transportit TAP të rezervuar duke iu referuar një Pike Hyrjeje dhe Pike Daljeje të veçantë për transportin e gazit natyror që u vihet në dispozicion Transportuesve për një periudhë prej më shumë se një viti dhe të cilën TAP nuk lejohet ta ndërpresë përveç mirëmbajtjes së planifikuar, kufizimeve të kapacitetit ose një force madhore.

Udhëzime do të thotë ky dokument, i miratuar nga Autoritetet, që përcakton se si TAP do të kryejë Testin e Tregut të nisur në vitin 2025, me qëllim që t'u ofrojë të gjitha palëve të interesuara Kapacitetin e Zgjerimit sipas seksionit 4.1.7 të FJO-së dhe të akomodojë Kërkesat për Lidhje.

Projekti i Kapacitetit Rritës do të thotë një projekt për të zgjeruar kapacitetin e TAP-it në pikat ekzistuese të hyrjes dhe/ose daljes së TAP-it ose për të krijuar pika të reja hyrjeje dhe/ose daljeje në sistemin e transportit të TAP-it, në përputhje me FJO-në dhe Kodin Tarifor të TAP-it.

Kapaciteti Fillestar do të thotë kapaciteti prej 10 miliardë metra kub/vit i ndërtuar dhe i vënë në dispozicion në fazën e parë të sistemit të transportit TAP, siç referohet në FJO.

Palë e Interesuar do të thotë çdo person juridik që është i interesuar të marrë pjesë në fazën jo-detyruese të Testit të Tregut të TAP-it.

Kërkesë e Lidhur do të thotë një kërkesë ku një Palë e Interesuar ka treguar se kërkesa e saj jo-detyruese për kërkesë në një Pikë Hyrjeje TAP varet nga caktimi i një sasi të barabartë kapaciteti dhe kohëzgjatjeje në një IP të dytë (Pikë Daljeje).

Testi i Tregut do të thotë procesi përmes të cilit TAP vlerëson kërkesën e tregut për Kapacitetin e Zgjerimit dhe Kërkesat për Lidhje, që përfshin një Fazë Jo-Detyruese, në të cilën Palët e Interesuara shprehin dhe përcaktojnë sasinë e kërkesave të tyre dhe një Fazë Detyruese në të cilën mund të hyjnë në fuqi angazhime detyruese.

Treguesi i Kërkesës Jo-Detyruese do të thotë Kërkesa për Kapacitet dhe/ose Kërkesa për Lidhje e treguar nga Pala e Interesuar nëpërmjet plotësimit të "Formularit të Regjistrimit dhe Treguesit të Kërkesës Jo-Detyruese".

Faza Jo-Detyruese do të thotë faza e përgjithshme e Testit të Tregut e cila përbëhet nga Fazat e Vlerësimit të Kërkesës dhe Projektimit të Koordinuar.

Tarifa e Pjesëmarrjes do të thotë shuma që duhet të paguhet nga Palët e Interesuara për pjesëmarrjen në Testin e Tregut të TAP-it - Faza Jo-Detyruese.

Propozim Projekti do të thotë dokumenti i përgatitur nga TAP dhe OST-të fqinje nëse raporti i vlerësimit të kërkesës identifikon kërkesën për projekte me kapacitet shtesë.

Kapaciteti Total do të thotë shuma e Kapacitetit Fillestar dhe Kapacitetit të Zgjerimit, siç referohet në FJO.

3. Faza e Vlerësimit të Kërkesës

TAP fton të gjitha Palët e Interesuara, pavarësisht nëse janë tashmë Palë të Regjistruara në TAP apo jo, të marrin pjesë në Testet e Tregut të TAP. TAP do t'i trajtojë të gjitha Palët e Interesuara në një mënyrë transparente dhe jo diskriminuese.

Për të marrë pjesë në Fazën e Vlerësimit të Kërkesës, çdo Palë e Interesuar duhet të përmbushë dispozitat e këtyre Udhëzimeve dhe të dorëzojë me sukses Formularin e Regjistrimit dhe të Treguesit të Kërkesës Jo-Detyrues, siç është publikuar në faqen e internetit të TAP-it dhe dokumentacionin përkatës. Lista e dokumentacionit të kërkuar do të publikohet në faqen e internetit të TAP-it së bashku me një njoftim (Njoftim i Fazës Jo-Detyrues) që informon Palët e Interesuara mbi hapjen e Testit të Tregut përmes fillimit të Fazës së Vlerësimit të Kërkesës.

Dorëzimi nga një Palë e Interesuar i Formularit të Regjistrimit dhe Treguesit të Kërkesës Jo-Detyruese dhe dokumentacionit përkatës nuk krijon asnjë detyrim për një Palë të Interesuar për të paraqitur një ofertë detyruese, as nuk do ta detyrojë TAP-in të investojë dhe të realizojë ndonjë Projekt Kapaciteti Rritës . Një Tarifë Pjesëmarrjeje prej 10,000 EUR paguhet nga çdo Palë e Interesuar që dëshiron të marrë pjesë në Testin e Tregut. Tarifa e Pjesëmarrjes ka për qëllim të mbulojë kostot administrative për TAP-in për kryerjen e Fazës së Vlerësimit të Kërkesës të Testit të Tregut dhe duhet të paguhet së bashku me dorëzimin e Formularit të Regjistrimit dhe Treguesit të Kërkesës Jo-Detyruese, jo më vonë se 8 javë nga hapja e Testit të Tregut. Megjithatë, TAP rezervon të drejtën e tij për të pranuar formularët e Treguesit të Kërkesës Jo-Detyruese - së bashku me pagesën e Tarifës së Pjesëmarrjes - të dërguara pas skadimit të këtij afati.

Tarifa e Pjesëmarrjes do t'i rimburohet secilës Palë të Interesuar nëse Testi i Tregut rezulton në instalimin e të paktën një njësie shtesë kompresori në TAP, pas një Testi të suksesshëm të Qëndrueshmërisë Ekonomike dhe ekzekutimit të të paktën një Marrëveshjeje Transporti Gazi (GTA) për Kapacitet Afatgjatë të Forcuar me çdo përdorues, edhe në rast se përdoruesi që lidh GTA-në është i ndryshëm nga Pala e Interesuar që bëri kërkesën. Kostot administrative të shkaktuara nga TAP për Testin e Tregut mund të merren në konsideratë për rilogaritjen e tarifave të TAP-it në përputhje me Klauzolën 3.3.3 (d) të Kodit Tarifor të TAP-it.

Mospagesa e Tarifës së Pjesëmarrjes nga Pala e Interesuar mund të rezultojë në shpërfilljen nga TAP të çdo Kërkeje për Kapacitet ose Kërkeje për Lidhje jo-detyruese të bërë nga ajo Palë e Interesuar.

Dokumentacioni i Testit të Tregut, i cili konsiderohet jo-konfidencial nga TAP, do të publikohet në faqen e internetit të TAP dhe do të vihet në dispozicion të publikut.

Në Fazën e Vlerësimit të Kërkesës, Palët e Interesuara mund të paraqesin Kërkesa për Kapacitet jo-detyruese për Kapacitet Afatgjatë të Firmës dhe/ose Kërkesa për Lidhje.

Për të bërë një dorëzim gjatë Fazës Jo-Detyruese, një Palë e Interesuar duhet të plotësojë Formularin e Regjistrimit dhe Treguesit të Kërkesës Jo-Detyruese (siç është publikuar në faqen e internetit të TAP-it) i cili duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- i. Lloji i kërkesës(ave):
 - a. Kërkesa(a) jo-detyruese për Kapacitet në pikat e hyrjes dhe/ose daljes të përcaktuara tashmë të TAP-it.
 - b. Kërkesë për Lidhje për ndërtimin e një pike shtesë hyrjeje dhe/ose daljeje në Greqi.
